



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri**

**FJALA E KREUT TË PREZENCËS, AMBASADORIT ROBERT BOSCH, NË
PARAQITJEN E BOTIMEVE TË OSBE-së PËR POLICIMIN**

28 tetor 2009

I nderuar Ministër Basha,
I nderuar Drejtori Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Z. Prenci
Zoti Emmanuel Bourel,

Është një nder për mua t'i drejtohem sot Policisë së Shtetit shqiptar në prezantimin e tri botimeve strategjike të OSBE-së për policimin;

- Manuali i OSBE-së për Policimin Demokratik
- Praktikat më të Mira të OSBE-së në Partneritetin Polici – Publik
- Manuali për Policinë dhe të Drejtat e të Miturve – të financuar nga Misioni i Përhershëm i Francës në OSBE.

Këto botime janë një shembull i qartë i asaj që ne e quajmë ndërdimensionalitet. Në to bashkohen Shteti i së Drejtës, Mirëqeverisja, Ndihma për policinë, demokratizimi dhe të drejtat e njeriut, të gjithë këta elementë të mandatit tonë të tanishëm.

Në sytë e publikut, policia është manifestimi më i qartë i qeverisë për sa i përket ruajtjes së sigurisë dhe rendit publik.

Duke zbatuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ligjin vendas dhe atë ndërkombëtar, ju jeni vazhdimisht nën trysinë e punës së rëndësishme dhe të vështirë për të luftuar kundër krimit ordiner dhe krimit të organizuar dhe, së fundi, kundër kërcënimeve që i bëhen sigurisë kombëtare dhe asaj ndërkombëtare nga terrorizmi.

Për qytetarët është, gjithashtu, shumë e rëndësishme që të shohin se rregullat respektohen, sidomos rregullat e trafikut rrugor, pasi ne shohim përditë se neglizhimi i tyre sjell shumë vdekje e dëmtime, të cilat përndryshe nuk do të kishin ndodhur.

Sipas strategjisë shtatëvjeçare të Policisë së Shtetit, qëllimi afatgjatë strategjik është krijimi i një mjedisi të sigurt për publikun shqiptar.

Kjo është ngushtësisht e lidhur me zbatimin e filozofisë së “policimit në komunitet”.

Në zonën e OSBE-së, koncepti i “policimit në komunitet” ka lindur si element madhor plotësues strategjik i praktikave tradicionale të policimit.

Megjithëse nuk jam i sigurt nëse ekziston një përkufizim i përgjithshëm për policimin në komunitet, një përkufizim, që të paktën mua më duket interesant, është ai i Departamentit amerikan të Shtetit, i cili e përcakton si më poshtë:

“policimi në komunitet është një filozofi që promovon strategjitë organizative, të cilat mbështesin përdorimin sistematik të teknikave të partneritetit dhe zgjidhjes së problemeve, për të trajtuar në mënyrë proaktive ato kushte imediate që shkaktojnë probleme në sigurinë publike, siç janë krimi, çrregullimet shoqërore dhe frika ndaj krimimit”.

Sido që të përkufizohet dhe zbatohet kjo filozofi, ajo do të ndikohet përherë, deri diku, nga kuadri ligjor ekzistues, kultura shoqërore mbizotëruese, klima aktuale politike dhe infrastruktura aktuale.

Në dy botimet e para që përmenda, OSBE-ja ka mbledhur praktikat më të mira të policimit demokratik dhe partneritetit polici-publik të Shteteve Pjesëmarrëse të OSBE-së.

Besoj se këto botime do të kthehen në mjete të dobishme në përpjekjet tuaja të vazhdueshme për të forcuar edhe më tej atmosferën e besimit dhe mirëkuptimit mes policisë dhe publikut të gjerë.

Botimi i tretë ka të bëjë me trajtimin e të miturve nga ana e policisë, duke përshkruar jo vetëm mënyrën sesi trajtohen të miturit që bien në konflikt me ligjin, por edhe ata që dëmtohen nga krimi apo janë në rolin e dëshmitarit.

Në këto raste, mendoj se duhet pasur parasysh mosha e re dhe niveli i zhvillimit i këtyre të miturve.

Për të qenë i qartë, nevoja për rezultate efikase kërkon edhe formulimin dhe vënien në zbatim të strategjive të veçanta.

Përveç kësaj, ekzistojnë edhe standarde ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të miturve.

Për këtë arsye, Prezenca e OSBE-së ka bashkëpunuar me delegacionin francez pranë OSBE-së në Vjenë dhe me Policinë e Shtetit për hartimin e një manuali rreth këtyre çështjeve.

Z. Ministër, për një punë efikase, Policisë i nevojitet jo vetëm mbështetja e pushtetit qendror e vendor dhe e institucioneve shtetërore, por edhe ajo e publikut të gjerë.

Shpresojmë se këta libra do ta ndihmojnë Policinë e Shtetit për arritjen e kësaj mbështetjeje.

Duke ju falënderuar për zemërsisht për vëmendjen, i uroj Policisë së Shtetit suksese në këtë pjesë të rëndësishme të punës së saj dhe shpresoj se këto botime do të jenë një ndihmë e përshtatshme në punën e saj.

Shumë faleminderit!